



---

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË  
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA  
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY  
DVSM

# *TESTI I MATURËS*

## ARSIMI PROFESIONAL I



Prishtinë, 23 qershor 2012

Emri dhe mbiemri i nxënësit .....


Shkolla.....

### Udhëzime:

**Koha:** Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.




6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

## KIMI





1. Me cilën metodë mund të ndahet rëra nga uji ?
  - A. Me filtrim
  - B. Me sublimim
  - C. Me ndarje me magnet
  - D. Me distilim fraksional
2. Sa është pH e një tretësire bazike ?
  - A. pH=1
  - B. pH=4
  - C. pH=7
  - D. pH=11
3. Cilat grimca subatomike gjenden në mbështjellësin elektronik të atomit ?
  - A. Vetëm neutronet
  - B. Vetëm elektronet
  - C. Protonet dhe neutronet
  - D. Protonet dhe elektronet
4. Si quhet reaksioni i bashkëveprimit të estereve me ujë ?
  - A. Hidrolizë
  - B. Elektrolizë
  - C. Esterifikim
  - D. Polimerizim
5. Cili nga komponimet vijuese, kur reagon me ujë liron hidrogjenin e gaztë ?
  - A. CH<sub>4</sub>
  - B. CaH<sub>2</sub>
  - C. NH<sub>3</sub>
  - D. H<sub>2</sub>S

6. Në këtë reaksion kimik, njëri nga produktet e fituara është:



- A. metil fenil ketoni
- B. metil benzeni
- C. etil benzeni
- D. klor benzeni

7. Cilat nga çiftet vijuese janë izomerë në mes vete ?



8. Çfarë mjedisi tregon tretësira ujore e klorurit të amonit ( $\text{NH}_4\text{Cl}$ )?

- A. Bazik
- B. Neutral
- C. Acidik
- D. Amfotern


9. Cili është dallimi në mes të jonit klorur ( $\text{Cl}^-$ ) dhe atomit të klorit ( $\text{Cl}$ ) ?

- A. Joni klorur ( $\text{Cl}^-$ ) ka një elektron më shumë sesa atomi i klorit ( $\text{Cl}$ )
- B. Joni klorur ( $\text{Cl}^-$ ) ka një proton më pak sesa atomi i klorit ( $\text{Cl}$ )
- C. Joni klorur ( $\text{Cl}^-$ ) ka një proton më shumë sesa atomi i klorit ( $\text{Cl}$ )
- D. Joni klorur ( $\text{Cl}^-$ ) ka një elektron më pak sesa atomi i klorit ( $\text{Cl}$ )

10. Cili reaksion ndodh gjatë elektrolizës së klorurit të kalciumit  $\text{CaCl}_2$  të shkrirë ?

- A.  $\text{Ca} \rightarrow \text{Ca}^{+2} + 2\text{e}^-$
- B.  $\text{Ca} + 2\text{e}^- \rightarrow \text{Ca}^{+2}$
- C.  $\text{Ca}^{+2} \rightarrow \text{Ca} + 2\text{e}^-$
- D.  $\text{Ca}^{+2} + 2\text{e}^- \rightarrow \text{Ca}$

11. Cili komponim përfitohet me oksidimin e propanolit-2 ?



**12.** Cilat sheqerna bëjnë pjesë në grupin e polisakarideve ?

- A. Fruktoza dhe glukoza
- B. Amidoni dhe celuloza
- C. Saharoza dhe laktoza
- D. Riboza dhe ribuloza

**13.** Në një epruvetë janë përzier kristalet e klorurit të natriumit (NaCl) dhe të klorurit të amonit (NH<sub>4</sub>Cl), nëse epruveta nxehet në flakëdhënës do të vërehet se:

- A. NaCl mbetet në pjesën e nxehtë ndërsa NH<sub>4</sub>Cl sublimon në pjesën e ftohtë të epruvetës
- B. të dy kripërat shkrihen
- C. të dy kripërat sublimojnë
- D. NH<sub>4</sub>Cl mbetet në pjesën e nxehtë ndërsa NaCl sublimon në pjesën e ftohtë të epruvetës





**14.** Një kimist i analizon dy substanca kimike A dhe B. Rezultatet e analizës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Lloji i analizës	Substanca A	Substanca B
Fortësia	E fortë	E butë
Ngjyra	E tejdukshme	E zezë
Dendësia	3.51	2.26
Përçueshmëria elektrike	Jopërçues	Përçues i mirë

Nga rezultatet e këtyre testeve përfundojmë se:

- A. substanca A është grafiti dhe substanca B diamanti
- B. substanca A është bakri dhe substanca B natriumi
- C. substanca A është diamanti dhe substanca B grafiti
- D. substanca A është natriumi dhe substanca B bakri

**15.** Cili nga hidrokarburet vijuese ka pikën e vlimit më të ulët ?



**16.** Cilat janë simbolet kimike të klorit, bakrit dhe bariumit ?

- A. Cl, Cu, Ba
- B. K, Ba, Br
- C. Cl, Cu, Br
- D. K, Br, B

17. Cilat nga këto okside kanë veti bazike ?

- A. CaO, CO<sub>2</sub>, CO
- B. CaO, Na<sub>2</sub>O, MgO
- C. SO<sub>3</sub>, N<sub>2</sub>O<sub>5</sub>, P<sub>4</sub>O<sub>10</sub>
- D. MgO, ZnO, SO<sub>2</sub>


18. Prej cilave metale përbëhet aliazhi i bronzit ?

- A. Fe dhe Ni
- B. Fe dhe Mn
- C. Cu dhe Sn
- D. Cu dhe Zn

19. Çfarë ngjyre ka fenolftaleina në mjedis bazik ?

- A. Të verdhë
- B. Të gjelbër
- C. Të kaltër në të gjelbër
- D. Të kuqe në të vjollce

20. Çfarë orbitale hibride ka atomi qendror i karbonit në komponimin vijues ?



- A. sp
- B. sp<sup>3</sup>
- C. sp<sup>2</sup>
- D. sp<sup>3</sup>d

21. Sa është përqendrimi në mol/dm<sup>3</sup> i tretësirës së dhënë në figurë ?

$$M(\text{C}_6\text{H}_{12}\text{O}_6) = 180 \text{ g mol}^{-1}$$


- A. 5.0 mol/dm<sup>3</sup>
- B. 0.5 mol/dm<sup>3</sup>
- C. 0.28 mol/dm<sup>3</sup>
- D. 0.03 mol/dm<sup>3</sup>



22. Cila vitaminë është e tretshme në yndyra ?

- A. Riboflavina
- B. Retinoli
- C. Vitamina H
- D. Vitamina C

23. Gjaku përfaqësohet ka pH=7, ndërsa uthulla ka pH=3.



Përqendrimi i joneve  $H^+$  (aciditeti) në gjak:

- A. është 3 herë më i vogël se në uthull
- B. është 4 herë më i vogël se në uthull
- C. është 1000 herë më i vogël se në uthull
- D. është 10000 herë më i vogël se në uthull

24. Duke u bazuar në tabelën e dhënë konstatojmë se: ngritja e pikës së shkrirjes të elementeve kalkogjene prej oksigjenit (O) deri tek teluri (Te) vjen si rezultat i:

- A. forcave të Van der Walsit
- B. lidhjes jonike
- C. fortësisë së lidhjes kovalente
- D. afinitetit elektronik

Elementi kimik	Pika e shkrirjes/ $^{\circ}C$
O	-219
S	+119
Se	+220
Te	+ 450

25. Cili nga halogjenalkanet vijuese përdoret për pastrimin kimik të tekstilit ?

- A. Enflurani
- B. Tetraklormetani
- C. Lindani
- D. Freoni

## BIOLOGJI

**26.** Cili nga këto gjene është heterozigot ?

- A. bbcc
- B. BBCC
- C. BbCc
- D. AABB

**27.** Sa palë çifte nervore dalin prej trurit të zvarranikëve ?

- A. 10 palë
- B. 12 palë
- C. 20 palë
- D. 24 pale

**28.** Cila nga këto bimë përmban më së shumti fitoncide ?

- A. Molla
- B. Dardha
- C. Kumbulla
- D. Dëllinja

**29.** Cili organ i tretjes te njeriu e pengon kalimin e ujit në rrugët e frymëmarrjes ?

- A. Faringu
- B. Laringu
- C. Epiglotisi
- D. Duodenumi

**30.** Në cilën pjesë të qelizës kryhet oksidimi i materieve organike përmes ciklit pentozik ?

- A. Ribozome
- B. Citoplazmë
- C. Kloroplaste
- D. Mitokondrie

**31.** Nëse te prindërit gjenotipi për përcaktimin e grupeve të gjakut është AA x BO, çfarë do të jetë gjenotipi te pasardhësit ?

- A. AO, AB
- B. AO, BO
- C. AB, OO
- D. OA, OB

**32.** Çka ndodh në organizmin e njeriut nëse nuk funksionojnë veshkat ?

- A. Ndërprerja e qarkullimit të gjakut dhe limfës
- B. Ndërprerja e prodhimit të insulinës dhe glukagonit
- C. Ndërprerja e prodhimit të hormoneve tiroksinë dhe trijodtironinë
- D. Ndërprerja e ekskretimit të produkteve përfundimtare të metabolizmit



- 33.** Cilat nga këto organele qelizore e mbrojnë organizmin nga mikroorganizmat ?
- A. Mitokondritë
  - B. Lizozomet
  - C. Aparati i Golxhit
  - D. Ribozomet
- 34.** Cila prej bimëve të mëposhtme është indikator biologjik që përcakton shkallën e ndotjes së mjedisit ?
- A. Likeni
  - B. Pisha
  - C. Gështenja
  - D. Fieri
- 35.** Cila metodë aplikohet për pastrimin e mjedisit të ndotur nga bakteriet duke i përdorur bazat ?
- A. Sterilizimi
  - B. Deratizimi
  - C. Pasterizimi
  - D. Dezinfektimi
- 36.** Cila është faza e fundit e ciklit të zhvillimit të bakteriofagut ?
- A. Depërtimi i acidit nukleik të virusit në qelizën bakteriale
  - B. Formimi i kapsidave dhe acideve nukleike të viruseve
  - C. Kompletimi dhe lirimi i bakteriofagëve të rinj
  - D. Ngjitja e virusit për sipërfaqen e qelizës bakteriale
- 37.** Gjatë procesit të frymëmarrjes shkëmbimi i dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>) në mes gjakut dhe ajrit bëhet përmes:
- A. trakeve
  - B. alveoleve
  - C. faringut
  - D. laringut
- 38.** Cilat etapa të njëpasnjëshme kryhen në interfazë gjatë një cikli të ndarjes qelizore ?
- A. G<sub>1</sub>-S-G<sub>2</sub>
  - B. G<sub>1</sub>-G<sub>2</sub>-S
  - C. S-G<sub>2</sub>-G<sub>1</sub>
  - D. G<sub>1</sub>-G<sub>2</sub>-S
- 39.** Qarkullimi i vogël i gjakut te njeriu:
- A. fillon nga barkushja e majtë dhe përfundon në veshëzën e djathtë
  - B. fillon nga veshëza e djathtë dhe përfundon në barkushen e majtë
  - C. fillon nga barkushja e djathtë dhe përfundon në veshëzën e majtë
  - D. fillon nga veshëza e majtë dhe përfundon në barkushen e djathtë

**40.** Sa aminoacide në sintezën e proteinave kodohen nga vargu i mëposhtëm i ARN(i) ?

UGGUUUGGCUCA

- A. Tri aminoacide
- B. Katër aminoacide
- C. Pesë aminoacide
- D. Tetë aminoacide

**41.** Cila nga këto organele nuk haset te qelizat e bimëve të larta ?

- A. Centrozomi
- B. Mitokondria
- C. Lizozomi
- D. Ribozomi

**42.** Cili hormon te njeriu e zvogëlon përqëndrimin e sheqerit në gjak ?

- A. Glukagoni
- B. Insulina
- C. Tiroksina
- D. Estrogjeni

**43.** Në cilën familje të dythelboreve bënë pjesë dardha ?

- A. Fluturore
- B. Ahore
- C. Trëndafilore
- D. Kompozite

**44.** Cili është roli i trikocistëve te papuqëza ?

- A. Për mbrojtje
- B. Për tajitje
- C. Për lëvizje
- D. Për ushqim

**45.** Si quhet procesi i gëlltitjes së bakteve nga rruazat e bardha të gjakut ?

- A. Pinocitozë
- B. Fagocitozë
- C. Osmozë
- D. Ekzocitozë

**46.** Cilat organe të tretjes i zbërthejnë tërësisht materiet ushqyese ?

- A. Laringu dhe lukthi
- B. Goja dhe lukthi
- C. Pankreasi dhe mëlçia
- D. Lukthi dhe zorra e hollë

**47.** Në cilin grup të eshtrave bënë pjesë femuri ?

- A. Eshtrat e gjymtyrëve
- B. Eshtrat e qafës
- C. Eshtrat e kafkës
- D. Eshtrat e kurrizit

**48.** Cila nga këto sëmundje është sëmundje e syrit ?

- A. Meningjitisi
- B. Katarakti
- C. Kariesi
- D. Difteria

**49.** Cili hormon nuk do të sintetizohet në organizmin e njeriut nëse nuk funksionon neurohipofiza ?

- A. Tiroksina
- B. Adrenalina
- C. Vazopresina
- D. Melatonina

**50.** Në cilin organ të organizmit të njeriut bëhet detoksikimi i materieve helmuese ?

- A. Në mëlçi
- B. Në mushkëri
- C. Në lukth
- D. Në pankreas

## INFORMATIKË

- 51.** Memoria virtuale (Virtual Memory) kombinon kapacitetin e RAM-it me një pjesë të memories nga:
- A. CD/DVD
  - B. ROM
  - C. Hard Disku
  - D. Kesh memoria
- 52.** Shtypësi mund të kyçet në:
- A. Portin paralel
  - B. Portin Serik
  - C. Portin e lojërave
  - D. Në cilin do port
- 53.** Fajllat me permbajtje të teksteve kanë prapashtesën (ekstensionin) vijuese?
- A. .pdf, .jpg, .php
  - B. .rtf, .doc, .txt
  - C. .htm, .jpg, .txt
  - D. .ppt, .jpg, .php
- 54.** Njësia ROM-BIOS është e vendosur në pllakën amë të kompjuterit dhe mundëson:
- A. Ruan programin për startimin e njësive hyrëse të sistemit kompjuterik
  - B. Ruan programin për startimin e njësive dalëse të sistemit kompjuterik
  - C. Ruan programin për të dhënat e RAM memories
  - D. Kontrollin e njësive harduerike dhe përcjelljen e sistemit operativ në memorien punuese.
- 55.** Të përcaktohet renditja e saktë e komponentëve të sistemit kompjuterik , mbështetur në shpejtësinë e transmetimit të të dhënave dhe duke filluar nga më e ngadalshmjia :
- A. disketa, CD-ROM, hard disk, RAM
  - B. RAM, Hard disk, CD\_ROM, disketa
  - C. Hard disk, RAM, CD\_ROM, disketa
  - D. RAM, hard disk, disketa, CD-ROM
- 56.** Cila nga shprehjet vijuese është e saktë:
- A.  $1\text{GB} < 1024\text{KB}$
  - B.  $1\text{GB} = 1024\text{MB}$
  - C.  $1\text{MB} = 1024\text{GB}$
  - D.  $1\text{GB} > 1024\text{MB}$
- 57.** Kartela e zërit lidh:
- A. Altoparlantët dhe procesorin
  - B. Altoparlantët dhe memorien
  - C. Altoparlantët dhe pllakën amë
  - D. Altoparlantët dhe hard diskun

- 58.** Cila nga formulimet e mëposhtme paraqet një adresë Interneti (IP adresë) :
- 145-124-202-34
  - 138@234@24@12
  - 112157189219
  - 110.39.213.218
- 59.** Shkurtesa e protokollit për transmetimin e të dhënave ndërmjet shfrytëzuesve të rrjetit, është:
- TCP/IP
  - URL
  - FTP
  - HTTP
- 60.** Cila pjesë e e-mail adresës travel@tourist.uk e tregon shfrytëzuesin:
- travel
  - uk
  - @
  - Tourist
- 61.** Cila nga opsionet vijuese konsiderohet praktikë e mirë me rastin e krijimit të e-mailave:
- Përdorimi i smiley-ve të ndryshme në fushën e mesazhit
  - Përdorimi i përshkrimit të shkurtë dhe konciz në fushën e temës (subject)
  - Shkrimi i mesazhit me shkronja bold
  - Shkrimi i mesazhit me shkronja të mëdha të shtypit
- 62.** Bazuar në funksionin e shkruar në celulën F2, pas ekzekutimit do të fitohet vlera:
- 26
  - 28
  - 25
  - 15
- 63.** Adresat absolute në programin MS Excel, të cilat nuk ndryshojnë të dhënat edhe kur formula që i përmbanë ato kopjohet në pozicione tjera, ka formën:
- \$(F28)
  - \$F28
  - F28\$
  - \$F\$28


	A	B	C	D	E	F	G
1							
2	4,8	6,3	8,1	7,4		=INT(SUM	
3							

- 64.** Në sllajde të një prezantimi mund të ketë:
- Foto, tekst, video-clip, grafik, etj.
  - Foto, tekst, grafik dhe video-clip të paraqitur në gjuhën HTML
  - Foto, tekst, video-clip dhe grafik, në formatin binar
  - Foto, tekst, video-clip, grafik, në formatin dekad
- 65.** Opsioni View/Master/Slide Master i programit PowerPoint mundëson:
- Krijimin e pjesëve të veçanta të një prezantimi
  - Krijimin e pjesëve të grafike të një prezantimi
  - Krijimin e pjesëve të përbashkëta të një prezantimi
  - Krijimin e pjesëve akustike të një prezantimi


## EKONOMI ME NDËRMARRËSI

- 66.** Numri më i madh i bizneseve në Kosovë, sipas formës ligjore të organizimit, janë biznese:
- ortakëri e përgjithshme
  - ortakëri e kufizuar
  - individuale
  - korporata
- 67.** Kur shpërndarja e të ardhurave dhe çmimet caktohen nga shteti kemi të bëjmë me:
- ekonomi të centralizuar
  - ekonomi të tregut
  - ekonomi të përzier
  - ekonomi në tranzicion
- 68.** Kosto alternative janë :
- kostot kontabël
  - kostot fikse
  - kostot oportune
  - kostot financiare

- 69.** Nëse nivelet e çmimit janë nën çmimin ekuilibër si në figurën e dhënë, sasia e kërkuar e produkteve e tejkalon sasinë e ofruar, duke krijuar:
- mungesë të produkteve e cila bën presion për rënien e çmimeve
  - mungesë të produkteve e cila bën presion për rritjen e çmimeve
  - tepricë të produkteve e cila bën presion për rritjen e çmimeve
  - tepricë të produkteve e cila bën presion për rënien e çmimeve



- 70.** Në tabelën e mëposhtme janë dhënë kombinime të ndryshme të çmimit dhe sasisë së kërkuar për produktin X. Paraqitni grafikisht të dhënat nga tabela. Lakorja e përfituar është:
- lakorja e kërkesës
  - lakorja e ofertës
  - lakorja e mundësive të prodhimit
  - lakorja e indiferencës



- 71.** Nëse çmimi i një produkti bie nga 4 € në 3€, kurse konsumatori vazhdon të blen 4 njësi si më parë, fuqia blerëse e konsumatorit do të:
- E. zvogëlohet për 4€
  - F. rritet për 3€
  - G. zvogëlohet për 3€
  - H. rritet për 4€
- 72.** Kënaqësia e tërësishme që konsumatori e përfiton nga konsumimi i produkteve dhe shërbimeve të blera paraqet:
- A. dobinë marxhinale
  - B. koston totale
  - C. dobinë totale
  - D. tepricën konsumatore
- 73.** Në analizën e zgjedhjes konsumatore, për çdo njësi shtesë të konsumit të një të mire:
- A. dobia marginale do të jetë në rënie
  - B. dobia marginale do të jetë në rritje
  - C. dobia totale do të jetë vazhdimisht në rënie
  - D. dobia totale do të jetë vazhdimisht në rritje
- 74.** Sipas sektorëve firmat ndahen në:
- A. të vogla, të mesme dhe të mëdha
  - B. parësor, dytësor, dhe tretësor
  - C. prodhuese dhe shërbyese
  - D. individuale, ortakëri dhe korporata
- 75.** Cila nga tiparet e mëposhtme i karakterizon korporatat?
- A. struktura e përbërë drejtuese
  - B. lehtësia për të hyrë në biznes
  - C. procedura e thjeshtë e regjistrimit
  - D. struktura e thjeshtë drejtuese
- 76.** Një nga tiparet e konkurrencës së plotë, është:
- A. disa shitës të produkteve në degë
  - B. pengesat e hyrjes së firmave të reja në degë
  - C. lehtësia e hyrjes së firmave të reja në degë
  - D. një shitës i produkteve në degë

- 77.** Firmat janë çmim-përcaktuese në kushtet e:
- A. oligopolit
  - B. monopolit
  - C. konkurrencës së plotë
  - D. konkurrencës monopolistike
- 78.** Paga si çmim i punës, përcaktohen në tregun e:
- A. produkteve dhe shërbimeve
  - B. tokës
  - C. faktorëve të prodhimit
  - D. kapitalit
- 79.** Produkti i Brendshëm Bruto (GDP) llogaritet si shumë e:
- A. konsumit, profitit, interesit, dhe neto eksportit
  - B. pagesave transferuese, interesit, dhe rentës
  - C. pagesave transferuese, interesit dhe profitit
  - D. konsumit, investimeve, shpenzimeve qeveritare dhe neto eksportit
- 80.** Periudha kur ekonomia fillon me rritjen e prodhimit dhe të ardhurave si dhe uljes së papunësisë është:
- A. pika më e lartë
  - B. ekspansioni
  - C. recesioni
  - D. niveli më i ulët